



Ulpiana Neighborhood | Zija Shemsu Str. | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
 T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

Politika - Përkushtimi ndaj cilësisë dhe sigurisë së informacionit

Në IPKO Telecommunications LLC, menaxhmenti i lartë, ekipi i ISO-s dhe të gjithë punonjësit janë të përkushtuar për të qenë lider në cilësi, siguri të informacionit dhe ofrimit të zgjidhjeve të besueshme të komunikimit dhe rrjetit.

Për të mbështetur këtë përkushtim, është themeluar Sistemi i Integruar i Menaxhimit (SIM), i bazuar në ISO 9001:2015 dhe ISO/IEC 27001:2022, për të siguruar menaxhim efektiv të proceseve, planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. SIM-i është në përputhje me drejtimin strategjik të IPKO-s dhe respekton kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme.

Nëpërmjet kornizës së SIM-it, IPKO do të:

- Vlerësojë dhe përmirësojë rregullisht SIM-in (SMC dhe SMSI) për të siguruar përputhshmëri me mjedisin afarist;
- Përbushë pritjet e klientëve duke ofruar produkte dhe shërbime inovative, në përputhje me kërkesat, me cilësi të lartë dhe të besueshme;
- Zhvillojë punonjësit duke u ofruar njohuritë, mjetet dhe shkathtësitë e nevojshme për rritje të vazhdueshme profesionale dhe përputhshmëri me standardet e certifikuara;
- Përdorë të dhënat dhe analizën e performancës për të mbështetur vendimmarrjen dhe drejtimin strategjik;
- Forcojë partneritetet me furnitorët për të rritur kapacitetet e përgjithshme;
- Sigurojë që politikat, manualët dhe procedurat të jenë të qarta, të qëndrueshme dhe në përputhje me angazhimet e kompanisë;
- Monitorojë treguesit e performancës dhe do të përmirësojë vazhdimisht kënaqshmërinë e klientëve dhe cilësinë e shërbimeve;
- Promovojë ndërgjegjësimin te punonjësit lidhur me rolin e tyre në arritjen e kënaqshmërisë së klientëve;
- Sigurojë komunikim efektiv të brendshëm dhe të jashtëm;
- Inkurajojë punën ekipore, zgjidhjen e problemeve dhe veprimet parandaluese në të gjithë organizatën, duke fuqizuar punonjësit si ambasadorë të cilësisë;
- Ofrojë mundësi të barabarta dhe do të sigurojë praktika të drejta dhe jodiskriminuese në rekrutim, ngritje në karrierë dhe zhvillim profesional;
- Integrojë SIM-in në operacionet e përditshme dhe në kulturën organizative si një angazhim afatgjatë ndaj cilësisë, përmirësimit të vazhdueshëm dhe kënaqshmërisë së klientëve;
- Angazhohet për përmirësim të vazhdueshëm dhe do të synojë të përbushë dhe të tejkalojë pritjet e klientëve;
- Sigurojë rishikim të rregullt të SIM-it nga menaxhmenti për të ruajtur efektivitetin e tij;



- Mbrojë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit përmes praktikave të forta të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave;
- Respektojë kërkesat ligjore, rregullatore dhe kontraktuale të zbatueshme;
- Forcojë sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e biznesit për të rritur qëndrueshmërinë e organizatës.

Menaxhmenti i lartë siguron që kjo politikë:

- Të jetë e përshtatshme me qëllimin dhe kontekstin e organizatës;
- Të përfshijë zotimin për përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhshmëri me kërkesat e SIM-it (SMC dhe SMSI);
- Të ofrojë një kornizë për përcaktimin dhe rishikimin e objektivave;
- Të komunikohet, kuptohet dhe zbatohet në të gjithë organizatën;
- Të rishikohet në baza periodike për përshtatshmëri dhe efektivitet të vazhdueshëm.